

Shoqata e Kontabilistëve të Çertifikuar dhe Auditorëve të  
Kosovës

Society of Certified Accountants and Auditors of Kosovo

Raportimi Financiar

**P5**

FLETË PROVIMI  
**Zgjidhjet**

Data 15.06.2019

1. Grupi Drogon sh.a përbëhet nga tri kompani të cilat prodhojnë paisje të zjarrit. Pasqyrat e veçanta financiare të kompanisë prind Drogon sh.a dhe kompanive në të cilat ka investuar, Rhaegal sh.a dhe Viserion sh.a me 31 dhjetor 2018 janë dhënë më poshtë:

	<b>Drogon sh.a €'000</b>	<b>Rhaegal sh.a €'000</b>	<b>Viserion sh.a €'000</b>
<i>Pasuritë jo-qarkulluese:</i>			
Prona, fabrika dhe paisjet	58,400	45,000	37,860
Investimet	<u>47,680</u>	<u>18,350</u>	<u>-</u>
	106,080	63,350	37,860
<i>Pasuritë qarkulluese:</i>			
Stoqet	8,500	13,250	8,590
Të arkëtueshmet tregtare dhe të tjera	25,400	10,800	8,720
Paraja dhe ekuivalentët e parasë	<u>1,200</u>	<u>2,800</u>	<u>3,350</u>
	<u>35,100</u>	<u>26,850</u>	<u>20,660</u>
<b>Total pasuritë</b>	<b>141,180</b>	<b>90,200</b>	<b>58,520</b>
<i>Ekuiteti:</i>			
Aksionet e zakonshme prej €1.00 secila	80,000	42,000	18,500
Fitimet e mbajtura	<u>48,000</u>	<u>22,800</u>	<u>18,200</u>
	128,000	64,800	36,700
<i>Detyrimet afatgjata:</i>			
Huamarrjet afatgjata	-	15,000	2,000
<i>Detyrimet afatshkurtëra:</i>			
Të pagueshmet tregtare dhe të tjera	<u>13,180</u>	<u>10,400</u>	<u>19,820</u>
<b>Total ekuiteti dhe detyrimet</b>	<b>141,180</b>	<b>90,200</b>	<b>58,520</b>

#### **Informata tjera:**

- (i) Drogon sh.a bleu 80% të aksioneve të ekuitetit të Rhaegal sh.a-së me 1 janar 2017 nëprmet një këmbimi të aksioneve prej 2 aksioneve në Drogon sh.a për çdo 5 aksione të blera në Rhaegal sh.a. Përveç kësaj, Drogon sh.a pagoi një konsideratë në para në shumë prej €30 milion në po atë datë. Vlera e drejtë një aksioni të Drogon sh.a me 1 janar 2017 ishte €3. Vlera e drejtë e një aksioni të Rhaegal sh.a me 1 janar 2017 ishte €2.5. Drogon sh.a ende nuk ka kontabilizuar konsideratën e emetimit të aksioneve në pasqyrat financiare.
- (ii) Me 1 janar 2017 Drogon sh.a gjithashtu bleu 7.4 milion aksione të Viserion sh.a për një konsideratë në para prej €14.8 milion. Drogon sh.a ka një anëtar të bordit që përfaqëson interesat në bordin e Viserion sh.a por nuk ka fuqi të caktoj shumicën e anëtarëve të bordit të Viserion sh.a.
- (iii) Fitimet e mbajtura të Rhaegal sh.a dhe Viserion sh.a me 1 janar 2017 ishin €14.5 milion dhe €3.8 milion respektivisht.

- (iv) Vlerat e drejtë e pasurive neto të identifikueshme të Rhaegal sh.a-së me 1 janar 2017 sihin të barabarta me vlerat e tyre bartëse me përjashtim të Tokës dhe Ndërtesave vlera e drejtë e të cilave ishte me e lartë se vlera bartëse për €6 milion. Nga kjo shumë, 75% kanë të bëjnë me ndërtesat jeta e mbetur e të cilave me 1 janar 2017 ishte 40 vite.
- (v) Gjatë vitit deri me 31 dhjetor 2018 Rhaegal sh.a shiti mallra tek Drogon sh.a me çmim €6.4 milion. Rhaegal sh.a shton një marzhë mbi kosto prej 25% në vendosjen e çmimit të këtyre mallrave. Gjysma e këtyre mallrave janë ende në stoqet e Drogon sh.a.
- (vi) Të pagueshmet e Drogon sha përfshijnë €1.4 milion ndaj Rhaegal sh.a. Por, të arkëtueshmet e Rhaegal sh.a's përfshijnë €6.4 milion ndaj Drogon sh.a. Diferenca ndërmjet të pagueshmeve të Drogon sh.a-së dhe të arkëtueshmeve të Rhaegal sh.a-së është për shkak të parasë në tranzit e dërguar nga Drogon sh.a por që nuk është pranuar ende nga Rhaegal sh.a.
- (vii) Me 1 korrik 2017, Drogon sh.a shiti një fabrikë tek Rhaegal sh.a për €15 milion. Vlera bartëse e fabrikës në atë datë ishte €10 milion. Fabrika kishte një jetë të mbetur ekonomike të përdorimit prej 5 viteve me 1 korrik 2017.
- (viii) Zëri i mirë në blerje të Rhaegal sh.a është demtuar për €5 milion përderisa investimi në Viserion sh.a është demtuar për €2.5 million.
- (ix) Drogon sh.a llogarit interesin jo-kontrollues sipas vlerës së drejtë. Për këtë qëllim, vlera e drejtë e aksioneve të Rhaegal sh.a me 1 janar 2017 është reprezentative e vlerës së drejtë të aksioneve të interesit jo kontrollues.

**Kërkohet:**

**Përgadite Pasqyrën e Konsoliduar të Pozitës Financiare për grupin Drogon sh.a me 31 dhjetor 2018.**  
**(25 pikë)**

1.

**Grupi Drogon sh.a**  
**Pasqyra e Konsoliduar e Pozitës Financiare me 31 dhjetor 2018**

€ 000

*Pasuritë jo-qarkulluese:*

PFP (L11)	105,675
Zëri i mirë (L12)	23,820
Investimet në shoqëri (L13)	18,060
Investimet tjera (L14)	<u>21,230</u>
	168,785

*Pasuritë qarkulluese:*

Stoqet (8,500 + 13,250 -640 L15)	21,110
Të arkëtueshmet tregtare dhe të tjera (L16)	29,800
Paraja (1,200+2,800+5,000)	<u>9,000</u>
	<u>59,910</u>

**Total pasuritë** **228,695**

**Ekuiteti dhe detyrimet**

Ekuiteti:

Aksionet e zakonshme (80,000+2/5 x 80% x 42,000x€1)	93,440
Premia e aksioneve (2/5 x 80% x 42,000X(3-1))	26,880
Fitimet e mbajtura të grupit (L18)	<u>49,708</u>
Ekuiteti i atribuar pronarve të prindit	170,028
IJK (L19)	<u>21,487</u>
Total ekuiteti	191,515

*Detyrimet afatgjata:*

Huamarrjet afatgjata	15,000
----------------------	--------

*Detyrimet afa-shkurtëra:*

Të pagueshmet tregtare dhe të tjera (13,180 + 10,400 -1,400)	<u>22,180</u>
--	---------------

**Total ekuiteti dhe detyrimet** **228,695**

**Llogaritjet:**

**L11. PPE**

€'000

Shumat e dhëna

Drogon sh.a	58,400
-------------	--------

Rhaegal sh.a	45,000
--------------	--------

Korigjimet

VD në blerje të Rhaegal sh.a	6,000
------------------------------	-------

Zhvl. i akm. VD 75% x 6,000/40 x 2	(225)
------------------------------------	-------

FPR në fabrikë (15,000-10,000)/5 x 3.5	<u>(3,500)</u>
--	----------------

**105,675**

<b>L12.</b>	<b>€'000</b>
Kosto e blerjes:	
Emetimi o aksioneve $2/5 \times 42,000 \times 80\% \times 3\text{€}$	40,320
Paraja	30,000
IJK në blerje $20\% \times 42,000 \times \text{€}2.5$	<u>21,000</u>
Equiteti në blerje.	
A.Z	(42,000)
F.M	(14,500)
VD rivl.	<u>(6,000)</u>
	<u>(62,500)</u>
Zëri i mirë në blerje	28,820
Minus humbja nga dëmtimi	<u>(5,000)</u>
	<b>23,820</b>
<b>L13. Investimet në shoqëri</b>	<b>€'000</b>
Kosto e investimit	14,800
Pjesa e fitimeve të mbajtura pas blerjes $40\% (18,200 - 3,800)$	5,760
Humbja nga dëmtimi	<u>(2,500)</u>
	<b>18,060</b>
<b>L14. Investimet tjera</b>	<b>€'000</b>
Drogon sh.a	47,680
Rhaegal sh.a	18,350
Minus investimet e Drogon sh.a në Rhaegal sh.a	(30,000)
Minus investimet e Drogon sh.a në Viserion sh.a	<u>(14,800)</u>
	21,230
<b>L15. FPR në stoke</b>	<b>€'000</b>
Shitje	6,400
Kosto $6400/1.25 =$	<u>5,120</u>
Fitimi	1,280
<b>FPR = <math>1,280 \times 0.5</math></b>	<b>640</b>
<b>L16. Të arkëtueshmet tregtare dhe të tjera</b>	<b>€'000</b>
Sipas detyres	
Drogon	25,400
Rhaegal	10,800
Intra-grupore	<u>(6,400)</u>
	<b>29,800</b>
<b>L17. Të pagueshmet tregtare dhe të tjera</b>	<b>€'000</b>
Drogon sh.a	13,180
Rhaegal sh.a	10,400
Intra-grupore	<u>(1,400)</u>
	<b>22,180</b>

<b>L18. Fitimet e mbajtura</b>	<b>€'000</b>
Drogon sipas detyres FM	48,000
Pjesa e fitimeve pas blerjes:	
Rhaegal 80%(22,800-14,500)	6,640
Viserion 40%(18,200-3,800)	5,760
Korigjimet:	
VD zhvl. 75%x6,000/40x2x80%	(180)
FPR në stoqet e shitura nga Rhaegal sh.a tek Drogon sh.a 25/125x 3,200 x 80%	(512)
FPR në fabrikë	(3,500)
Humbjet nga dëmtimi: Zëri i mirë 80%x5,000	(4,000)
Shoqëria	<u>(2,500)</u>
	<b>49,708</b>

<b>L19. IJK</b>	<b>€'000</b>
Në blerje	21,000
Pjesa e fitimeve pas blerjes:	
FM 20%(22,800-14,500)	1,660
VD zhvl. 20%x75% x 6,000/40 x 2	(45)
FPR 20% x 640	(128)
Dëmtimi i zërit të mirë 20%x5,000	<u>(1,000)</u>
	<b>21,487</b>

2. Ghost sh.a është një kompani që merret me prodhimin e biskotave. Ngjarjet në vijim kanë ndodhur gjatë vitit të përfunduar me 31 dhjetor 2018 për Ghost sh.a.

**Kërkohet:**

**Për secilën ngjarje më poshtë, diskuto nëse provizionet duhet të njihen në pajtim me SNK 37 *Provizionet, detyrimet kontigjente dhe pasuritë kontigjente.***

- i) Ghost sh.a është aktualisht duke zgjëruar biznesin e tij globalisht në tregje të huaja. Në korrik 2018, operacionet e fabrikës në vendet e huaja kanë ndotur seriozisht ambientin dhe kostot që kanë mundësi të ndodhin janë vlerësuar në €8,500,000. Edhe pse nuk ka ligj mbi ambientin në vendin e huaj, kompania ende pretendon të jetë qytetar korporativ i përgjegjshëm ndaj shoqërisë dhe ndaj mjedisit. **(5 pikë)**
- ii) Bordi i drejtorëve të Ghost sh.a-së në dhjetor 2018 vendosi që pas një viti të ristrukturoj kompaninë për shkak të kushteve të pafavorshme ekonomike. Ristrukturimi përfshin mbylljen e degëve të saj në Winterfell dhe Castle Black. Për shkak të kësaj, 20% e stafit do të jetë tepricë. Ghost sh.a nuk ka vendosur akoma se cilët punëtorë do të afektohen dhe nuk i ka njoftuar se do të ristrukturohet. **(4 pikë)**
- iii) Një nga furnizuesit e kokosit, Hot Pie sh.a ka publicitet negativ për shkak të papastërtisë së fabrikës. Andaj me 1 shtator 2018, Ghost sh.a vendosi të ndërprej kontratën me Hot Pie sh.a. Kontrata do të skadoj pas 8 muajve. Sipas kontratës, kosto për të përmbushur kontratën është €80,000 në muaj. Gjithashtu është përcaktuar në kontratë se Hot Pie sh.a mund të pranoj një kompenzim prej €700,000 nëse kontrata ndërpritet më shumë se 6 muaj para se të përfundoj. **(6 pikë)**

2.

- i) Ghost sh.a duhet të njohë një provizion për kostot e pastrimit. Edhe pse nuk ka obligim aktual ligjor (nuk ekzistojnë ligje për mbrojtjen e ambientit) kompania ka obligim konstruktiv (reputacionin si kompani e përgjegjshme për shoqërinë dhe mjedisin) për shkak të ngjarjeve të kaluara (ndotja e mjedisit) dhe shuma e daljeve në të ardhmen mund të matet me besueshmëri e cila është €8,500,000. **(5 pikë)**
- ii) Ghost sh.a nuk duhet të njohë një provizion sepse informata nuk është përçuar tek palët e afektuara. Me qëllim të njohjes së një provizioni, duhet të ketë një plan të detajuar për ristrukturim dhe të ketë krijuar pritje valide tek palët e afektuara që do të përfundoj ristrukturimin. **(4 pikë)**
- iii) Situata është shembull i një kontrate me humbje sepse Ghost sh.a akoma do t'i ketë humbjet e pashmangshme të pagesës së kostos aktuale të përmbushjes së kontratës ose pagesën e kompenzimit sipas kontratës edhe pse Ghost sh.a nuk pranon me furnizime të kokosit nga Hot Pie sh.a.  
Prandaj, Ghost sh.a duhet të ndaj një provizion sepse:
- Ka një obligim aktual si rezultat i ngjarjeve të kaluara për shkak të nënshkrimit të kontratës nga Ghost sh.a.
  - Rrjedha dalëse e resurseve është e mundur sepse Ghost sh.a duhet të paguaj ose koston aktuale të kontratës ose pagesën e kompenzimit sipas kontratës.
  - Shuma mund të matet me besueshmëri e cila është më e ulët se kosto e përmbushjes së kontratës dhe pagesës së kompenzimit. **(6 pikë)**

### 3.

a) Missandei sh.a, një kompani e cila raporton sipas SNRF-ve është duke marrë parasysh ndryshimet në vijim në pasqyrat e saj financiare për vitin e përfunduar me 31 dhjetor 2018. Missandei sh.a paraqet informata krahasuese të një vitit më parë.

- i) Ndryshimi i metodës së zhvlerësimit të fabrikës nga metoda drejtvizore përgjatë 5 viteve (me vlerë të mbetur zero) në metodën e saldos së zbritur prej 20% në vit efektive nga 1 janar 2018. Fabrika fillimisht kishte kushtuar €100 milion me 1 janar 2016.
- ii) Ndryshimi i bazës së vlerësimit të disa stoqeve jo-sezonale nga i pari brenda i pari jashtë (FIFO) në koston mesatare të ponderuar (KMP). Stoqet janë vlerësuar si në vijim sipas të dy metodave të ndryshme:

	31 dhjetor 2016 € milion	31 dhjetor 2017 € milion	31 dhjetor 2018 € milion
FIFO	64	66	71
KMP	62	63	67

- iii) Ndryshimi i bazës së njohjes së të hyrave për disa mallra sezonal të cilat së pari ishin shitur në vitin 2016 dhe të hyrat do të njihen në momentin e dërgesës tek klientët e jo në momentin e ngarkimit për transport. Kjo ka ndodhur si rezultat i ndryshimit të aranzhimeve të dërgesës në atë mënyrë që nga data 1 janar 2018, rreziqet tani i bart Missandei sh.a deri në momentin e dërgimit të mallrave tek klienti.

	2016 € milion	2017 € milion	2018 € milion
Të hyrat bazuar në datën e ngarkesës	50	86	90
Të hyrat bazuar në datën e dërgimit	46	84	88

Kostoja e mallrave sezonal është gjithmonë 80% e çmimit të shitjes.

Fitimi (i llogaritur sipas politikave aktuale dhe vleresimeve aktuale në kontabilitet) ishte €240 milion për vitin e përfunduar me 31 dhjetor 2018.

#### **Kërkohet:**

**Llogariti korigjimet në fitime e mbajtura në fillim në pasqyrën e ndryshimeve në ekuitet (përfshirë shifrat krahasuese të vitit 2017) në pasqyrat financiare për vitin e përfunduar me 31 dhjetor 2018; dhe fitimin ose humbjen për vitin e përfunduar me 31 dhjetor 2018. (6 pikë)**

b) Tormund sh.a morri një licence pa pagesë nga qeveria për të operuar një minierë. Tormund sh.a shpenzoi €250 milion para se miniera të fillonte operimin me 1 janar 2018.

Licenca kërkon nga Tormund sh.a që në fund të jetës së përdorimit të minierës prej 25 viteve, ta kthej punishten në gjendjen e mëparshme (ristauroj). Tormund sh.a vlerësoi që kosto pas 25 viteve e kthimit të punishtës në gjendjen e mëparshme do të jetë €180 milion dhe vlera e tanishme është e kësaj shume është €120 milion.

Me 31 mars 2019 vërshimet dëmtuan fabrikën dhe paisjet në minierë dhe është vlerësuar se miniera do të mbyllet për së paku 1 vit dhe do të kushtoj €75 milion për tu riparuar fabrikën dhe paisjet.

Pasqyrat financiare për vitin e përfunduar me 31 dhjetor 2018 janë aprovuar për publikim me 15 prill 2019.

**Kërkohet:**

**(i) Shpjego se si kostoja e ristaurimit duhet të kontabilizohet në pasqyrat financiare për vitin e përfunduar me 31 dhjetor 2018 në pajtim me SNK 37 *Provizionet, detyrimet kontigjente dhe pasuritë kontigjente.*** (3 pikë)

**(ii) Shpjego trajtimin në kontabilitet të dëmeve të shkaktuara nga vërshimet në pasqyrat financiare për vitin e përfunduar me 31 dhjetor 2018 në pajtim me SNK 10 *Ngjarjet pas periudhës raportuese.*** (3 pikë)

c) Gendry sh.a operon tri linja të ndryshme të prodhimit të paisjeve për kuzhinë: thika, pjata dhe gota. Secila linjë e produkteve trajtohet si një linjë e veçantë e biznesit. Fabrika e thikave është duke operuar me humbje për shkak të konkurrencës nga konkurentët më të lirë. Fabrika e thikave kishte €150 milion humbje për vitin e përfunduar me 31 dhjetor 2018. Me 31 dhjetor 2018 menaxhmenti vendosi të mbyll fabrikën e thikave dhe të ndërpres shitjen e thikave. Kostot e mbylljes u vlerësuan të jenë €25 milion.

Më 31 dhjetor 2018 menaxhmenti ishte ende duke negociuar kompenzimet për punëtorët e pushuar nga puna me sindikatën e punëtorve dhe ende nuk kanë arritur marrëveshje lidhur me datën e mbylljes së fabrikës. Menaxhmenti ende nuk ka gjetur blerës për fabrikën e thikave sepse janë duke pritur raportin e vlerësimit të fabrikës. Menaxhmenti kërkon nga ju këshilla të trajtimit në kontabilitet të fabrikës së thikave.

**Kërkohet:**

**Shpjegoni trajtimin në kontabilitet të fabrikës së thikave sipas SNRF 5 *Pasuritë jo-qarkulluese të mbajtura për shitje dhe operacionet e ndërprera.*** (3 pikë)

d) Margaery sh.a ka në pronësi një ndërtesë të cilën e përdor si zyre dhe ka një politikë të rivlerësimit në baza të rregullta të ndërtesës. Kostoja në fillim të blerjes së ndërtesës me 1 janar 2013 ishte €25,000,000. Ndërtesa supozohet se ka jetë të përdorimit prej 50 vite dhe nuk ka vlerë mbetëse. Zhvlerësimi bëhet në baza drejtvizore. Ndërtesa është rivlerësuar me 31 dhjetor 2015 nga një vlerësues profesionist me një çmim të tregut €28,200,000. Në vitin 2018 vlerat e pronave ishin përkeqësuar dhe ndërtesa ishte rivlerësuar me 31 dhjetor 2018 nga një vlerësues profesionist me çmim të tregut prej €24,000,000.

**Kërkohe:**

**Shpjego trajtimin në kontabilitet të ndërtesës në pasqyrat financiare të Margaery sh.a sipas SNK 16 *Prona, fabrika dhe paisjet* në vitin e përfunduar me 31 dhjetor 2018 (të gjitha llogaritjet përkatëse duhet të tregohen). (5 pikë)**

**[Total: 20 pikë]**

a)	<b>Aplikim retrospektiv</b>	
Fitimet e mbajtura	<b>Viti paraparak</b>	<b>2018</b>
	<b>€ milion</b>	<b>€ milion</b>
Fitimi duke përdorur politikat aktuale	-	240
Metoda e zhvlerësimit (ndryshim në vlerësim)		
Zhvlerësimi i vjetër 100 / 5 vite		20
Zhvlerësimi i rishikuar (100 x 3/5) x 20%		(12)
Vlerësimi i stoqeve (ndryshim në politikë)		
Korigjim i stoqeve në fillim (62 - 64) / (63 - 66)	(2)	3
Korigjim i stoqeve në fund (67 - 71)		(4)
Të hyrat (ndryshim i natyres e jo politikës, andaj aplikohet nga 1 jan 2018 (88 - 90) x 20%		<u>(0.4)</u>
	<u>(2)</u>	<b>246.6</b>

**b)**

- (i) SNK 37 Provizionet, detyrimet kontigjente dhe pasuritë kontigjente kërkon që një entitet të njoh një provizion nëse ka obligim aktual për të transferuar përfitime ekonomike në të ardhmen, ka gjasa që transferi do të ndodhë dhe shuma mund të matet me besueshmëri. Sa i përket kostos së restaurimit të punishtes së minierës, Tormund sh.a ka një obligim ligjor që të shkaktoj koston. Një provizion duhet të njihet me 1 janar 2018. Pasi që shuma e kostos nuk varet nga vëllimi i përdorimit të minierës, e tërë kostoja duhet të njihet në atë datë dhe të trajtohet si pjesë e kostos së minierës (pra provizioni duhet të kapitalizohet).

Provizioni fillimisht do të matet në vlerën e tanishme prej €120 milion (Pra, D PFP, K Provizion). Më pas, provizioni i njohur fillimisht do të rritet me çkurdisjen e skontimit. Krijta do të ngarkohet në F/H për secilën periudhë.

- (ii) Dëmtimi i fabrikës e përmbush përkufizimin e një ngjarje pas periudhës raportuese pasi që ka ndodhur pas përfundimit të vitit por para datës së autorizimit për publikimin e pasqyrave financiare dhe shpenzimet e riparimeve janë materiale.

Megjithatë, ngjarja është ngjarje jo-korigjuese pasi që kushtet nuk kanë ekzistuar në datën e raportimit 31 dhjetor 2018. SNK 10 kërkon që kjo ngjarje të mos i afektoj rezultatet e vitit 2018. Kostoja e riparimeve do të ngarkohet në vitin 2019 (pejudha në të cilën ngjarja ka ndodhur). Por, ngjarja duhet të shpalojë në pasqyrat financiare për vitin e përfunduar me 31 dhjetor 2018.

- (c) Sipas SNRF 5 Pasuritë jo-qarkulluese të mbajtura për shitje dhe operacionet e ndërprera, fabrika e thikave është një operacion i vazhdueshëm sepse:

- i) Shitja nuk ka gjasa të mëdha të ndodh. Menaxhmenti nuk e ka caktuar çmimin e shitjes, pasi që po presin raportin e vlerësimit të fabrikës.
- ii) Pasuria nuk është në dispozicion për shitje të menjëhershme në kushtet aktuale të saj. Vlerësuesi nuk ka përcaktuar kushtet dhe vlerën e saj.
- iii) Menaxhmenti nuk ka një plan apo program aktiv për të gjetur blerësin.
- iv) Fabrika nuk është mbyllur dhe menaxhmenti është ende duke negociuar kompenzimin e punëtorve deri me datë 31 dhjetor 2018.
- v) Nuk ka gjasa që shitja do të ndodh në vitin e ardhshëm.
- vi) Fabrika e thikave duhet të raportohet si operacion i vazhdueshëm dhe jo si një pasuri e mbajtur për shitje apo operacion i ndërprerë.

**(d)**

1. Teprica e rivlerësimit me 31 dhjetor 2015 ishte:

$$(28,200,000) - (25,000,000 - 1,500,000) = 4,700,000$$

Kjo shumë do të raportohet në të ardhurat tjera gjithëpërfshirëse dhe do ta rrisë vlerën e pasurisë në pasqyrën e pozitës financiare.

2. Fitimi apo humbja e vitit 2016 do të raportoj zhvlerësim prej  $(28,200,000/47$  viteve) €600,000

3. Shuma e dëmtimit me 31 dhjetor 2018 është:

$$(24,000,000) - (28,200,000 - 1,800,000) = €2,400,000$$

4. Shuma e bartëse e rivlerësimit do të zvogëlohet për €2,400,000.

5. Ndërtesa do të vlerësohet në shumën prej €24,000,000 në pasqyrën e pozitës financiare.

4. Bilanci vertetues i Targaryen sh.a me 31 dhjetor 2018 është si më poshtë:

	Shënim	€' 000	€' 000
Shitjet	(i)		60,000
Shpenzimet administrative		9,000	
Shpenzimet e shpërndarjes		4,500	
5% Notë kreditore (emetuar 2017, e ripagueshme 2027)			14,000
Kosto e shitjes		27,700	
Mbitërheqja bankare			2,800
Dividendat e paguar me 30 nëntor 2018		2,750	
Interesi i paguar në kredi		350	
Tatimi në fitim	(ii)	500	
Stoqet me 31 dhjetor 2018	(iii)	9,300	
Toka dhe ndërtesa sipas kostos	(iv)	48,000	
Zhvlerësimi i akumuluar i ndërtesës me 1 janar 2018			1,650
Fabrika dhe paisjet sipas kostos	(v)	24,000	
Zhvlerësimi i akumuluar i fabrikës dhe paisjeve me 1 janar 2018			11,700
Aksionet e zakonshme prej €1 secila me 1 janar 2018			27,500
Premia e aksioneve			5,500
Provizionet për tatimin e shtyrë me 1 janar 2018	(ii)		3,750
Licenca	(vi)	4,500	
Amortizimi i akumuluar i licences me 1 janar 2018			1,350
Fitimet e mbajtura me 1 janar 2018			6,050
Të arkëtueshet tregtare/Të pagueshmet tregtare	(vii)	<u>6,750</u>	<u>3,050</u>
		<b>137,350</b>	<b>137,350</b>

**Informatat në vijim janë të rëndësishme:**

- (i) Shumat e të hyrave nga shitja përfshijnë €750,000 para të pranuar në avans për mallrat që do të prodhohen dhe dërgohen në janar 2019.
- (ii) Saldo e tatimin në fitim në bilancin vertetues paraqet mbi/nën provizionimin e tatimit për vitin e përfunduar me 31 dhjetor 2017. Vlerësimi i tatimit në fitim për vitin 2018 është €2,600,000 dhe provizioni për tatimin e shtyrë duhet të rritet €750,000.
- (iii) Shuma e stoqeve në bilancin vertetues përfshin artikuj të cilat kanë kushtuar €300,000 por kanë vlerë neto të realizueshme prej €200,000.
- (iv) Shuma e tokës e përfshirë në tokën dhe ndërtesat sipas kostos është €8,000,000 dhe ndërtesat zhvlerësohen me 5% në vit sipas metodës drejtvizore. Zhvlerësimi i ndërtesave trajtohet si shpenzim administrativ.
- (v) Fabrika dhe paisjet zhvlerësohen me 20% në vit sipas saldosh zbritëse dhe zhvlerësimi i fabrikës dhe paisjeve trajtohet si kosto e shitjes.
- (vi) Licenca ka jetë të përdorimit prej 10 viteve dhe amortizohet në baza sistematike përgjatë jetës së saj të përdorimit. Amortizimi trajtohet si kosto e shitjes.

- (vii) Kompania vendosi të shlyej nga librat €100,000 të llogarive të arkëtueshme pasi që gjykata ka shpallur bankrotimin për këtë klient me 30 nëntor 2018.

**Kërkohet:**

- (a) **Përgadite Pasqyrën e të Ardhurave të Targaryen sh.a për vitin e përfunduar me 31 dhjetor 2018. (10 pikë)**
- (b) **Përgadite Pasqyrën e Pozitës Finaciare të Targaryen sh.a për vitin e përfunduar me 31 dhjetor 2018. (10 pikë)**
- (Total: 20 pikë)**

#### 4.

##### Llogaritjet

L11 Të hyrat nga shitja: Rriten të hyrat e shtyera €750 zvogëlohen shitjet €750

L12 tatimi në fitim  $500 + 2,600 + 750 = €3,850$ . Tatimi i shtyrë  $3,750 + 750 = €4,500$

L13 stoqet  $9,300 - 300 + 200 = €9,200$

L14 Toka dhe ndërtesat: Zhvl =  $48,000 - 8,000 = 40,000 @ 5\% = €2,000$  shp. admin

V.N.L =  $48,000 - 1,650 - 2,000 = €44,350$

L15 Fabrika dhe paisjet: Zhvl =  $24,000 - 11,700 = 12,300 @ 20\% = €2,460$  Kosto e shitjeve

V.N.L =  $24,000 - 11,700 - 2,460 = €9,840$

L16 Licence: Amortizimi =  $4,500 / 10$  vite = 450 Kosto e shitjeve

V.N.L =  $4,500 - 1,350 - 450 = €2,700$

L17 rritja e borxheve të këqija €100 (shp. admin) zvogëlim i të arkëtueshmeve tregtare €100

##### Targaryen sh.a

##### Pasqyra e të Ardhurave për vitin e përfunduar me 31 dhjetor 2018

	€'000
Të hyrat nga shitja (60,000 - 750 l11)	59,250
Kosto e shitjeve (27,700 + 2,460 l15 + 450 l16 + 100)	<u>(30,710)</u>
Fitimi bruto	28,540
Shpenzimet administrative (9,000 + 2,000 l14 + 100 l17)	(11,100)
Kosto e shpërndarjes	(4,500)
Kosto financiare 14,000 @ 5%	<u>(700)</u>
Fitimi para tatimit	12,240
Tatimi (l12)	<u>(3,850)</u>
<b>Fitimi për vitin</b>	<b>8,390</b>

##### Targaryen sh.a

##### Pasqyra e Pozitës Financiare me 31 dhjetor 2018

	€' 000
<b>Pasuritë</b>	
Pasuritë jo-qarkulluese:	
Toka dhe ndërtesat (l14)	44,350
Fabrika dhe paisjet (l15)	9,840
Licenca l16	<u>2,700</u>
	56,890
Pasuritë qarkulluese:	
Stoqet (l13)	9,200
Të arkëtueshmet tregtare (6,750 - 100 l17)	<u>6,650</u>
	<u>15,850</u>
<b>Total pasuritë</b>	<b>72,740</b>
<b>Ekuiteti dhe detyrimet</b>	
Ekuiteti:	
Aksionet e zakonshme	27,500
Premia e aksioneve	5,500
Fitimet e mbajtura (6,050 + 8,390 - 2,750 (B.V))	<u>11,690</u>
	44,690
Detyrimet:	
Detyrimet afatgjata:	
5% Notë krediti	14,000
Tatimi i shtyrë (3,750+750))	<u>4,500</u>
	18,500

*Detyrimet afatshkurtëra:*

Të pagueshmet tregtare	3,050
Mbitërheqja bankare	2,800
Kostot financiare akruale (700- 350 (B.V))	350
Të hyrat e shtyera II1	750
Tatimi në fitim	<u>2,600</u>
	<u>9,550</u>
<b>Total ekuiteti dhe detyrimet</b>	<b>72,740</b>

5. Stark sh.a dëshiron të blejë një të dy kompanitë më poshtë dhe juve si analist financiar iu janë dhënë pasqyrat financiare të të dy kompanive nga zyrtari kryesor financiar për të ju ndihmuar që të analizoni performancën dhe pozitën financiare të kompanive dhe t'i rekomandoni kompanisë Stark sh.a lidhur me blejen e një të kompani dhe arsyet për rekomandimin tuaj.

#### Pasqyra e të ardhurave për vitin e përfunduar me 31 dhjetor 2018

	<b>Lannister sh.a</b>	<b>Baratheon sh.a</b>
	<b>€' milion</b>	<b>€' milion</b>
Të hyrat nga shitja	1,420	1,525
Kosto e shitjeve	<u>(775)</u>	<u>(755)</u>
Fitimi bruto	645	770
Shpenzimet administrative	(120)	(185)
Kostot e shpërndarjes	<u>(220)</u>	<u>(325)</u>
Fitimi operativ	305	260
Kosto financiare	<u>-</u>	<u>(25)</u>
Fitimi para tatimit	305	235
Tatimi	<u>(30)</u>	<u>(25)</u>
<b>Fitimi për vitin</b>	<b>275</b>	<b>210</b>

#### Pasqyra e Pozitës Financiare me 31 dhjetor 2018

	<b>Lannister sh.a</b>		<b>Baratheon sh.a</b>	
	<b>€' milion</b>	<b>€' milion</b>	<b>€' milion</b>	<b>€' milion</b>
Pasuritë				
Pasuritë jo-qarkulluese:				
Prona, fabrika dhe paisjet		1,225		2,095
Pasuritë qarkulluese:				
Stoqet	455		1,465	
Të arkëtueshmet tregtare	230		375	
Paraja/Banka	<u>320</u>		<u>75</u>	
<b>Total pasuritë</b>		<b><u>1,005</u></b>		<b><u>1,915</u></b>
		<b>2,230</b>		<b>4,010</b>
Ekuiteti				
Aksionet e zakonshme 1€		1,590		2,685
Fitimet e mbajtura		<u>540</u>		<u>885</u>
		2,130		3,570
Detyrimet				
Detyrimet afatgjata:				
10% Nota krediti		-		250
Detyrimet afatshkurtëra:				
Të pagueshmet tregtare		<u>100</u>		<u>190</u>
<b>Total ekuiteti dhe detyrimet</b>		<b>2,230</b>		<b>4,010</b>

Shënim: Të dy kompanitë janë në sektorin e njëjtë dhe treguesit kyq të performancës për vitin 2018 janë dhënë më poshte për të ndihmuar në analizimin e dy kompanive.

(i)	Marzha e fitimit bruto	35%
(ii)	Marzha e fitimit operativ	20%
(iii)	KNKA (Fitimi operativ/Kapitali i angazhuar)	20%
(iv)	Ditët e të pagueshmeve tregtare	60 ditë
(v)	Qarkullimi i stoqeve	1.5 herë
(vi)	Koeficienti i shpejtë	1.0 herë
(vii)	Koeficienti Borxh/Ekuitet	50%
(viii)	Fitimi për aksion	€0.20

**Kërkohet:**

- (a) Llogariti koeficientët më lartë për Lannister sh.a dhe Baratheon sh.a për vitin 2018.  
(8 pikë)
- (b) Analizoni performancën dhe pozitën financiare të kompanive dhe rekomandoni kompanisë Stark sh.a cilën kompani duhet ta blejë dhe arsyet për rekomandimin tuaj.  
(12 pikë)
- (Total: 20 pikë)

## 5.

### (a)

	<b>Lannister sh.a</b>	<b>Baratheon sh.a</b>
(i) Fitimi Bruto %	$645/1,420 = 45.4\%$	$770/1,525 = 50.5\%$
(ii) Fitimi Operativ %	$305/1,420 = 21.5\%$	$260/1,525 = 17\%$
(iii) KNKA	$305/2,130 = 14.3\%$	$260/1,525 = 6.8\%$
(iv) Ditët e LL/P	$100/775 \times 365 = 47$ ditë	$190/755 \times 365 = 92$ ditë
(v) Qarkullimi i stoqeve	$775/455 = 1.7$ herë	$755/1,465 = 0.5$ herë
(vi) Koeficienti i shpejtë	$550/100 = 5.5$ herë	$450/190 = 2.4$ herë
(vii) Borxh/Ekuitet	-	$250/3,570 \times 100 = 7\%$
(viii) FPA	$275/1,590 = €0.17$	$210/2,685 = €0.08$

### (b) Analiza e performancës dhe pozitës financiare dhe rekomandimi

#### Koeficientët e profitabilitetit

- (i) Baratheon sh.a ka raportuar marzhë bruto të fitimit më të lartë se sa Lannister sh.a dhe treguesit e industrisë. Baratheon sh.a duket së është dukë përfituar nga zbritjet tregtare apo furnizime më të lira pasi që kostoja e shitjeve është 49.5% e shitjeve krahasuar me 54.6% të Lannister sh.a.
- (ii) Lannister sh.a ka raportuar marzhë më të lartë të fitimit operativ se sa Baratheon sh.a dhe treguesit e industrisë. Lannister sh.a duket se i kontrollon shpenzimet operative në mënyrë më efikase pasi që paraqesin 23.9% të shitjeve ndërsa shpenzimet e shitjeve dhe administrative të Baratheon sh.a paraqesin 33.4% të shitjeve.
- (iii) Lannister sh.a ja raportuar KNKA më të lartë se sa Baratheon sh.a dhe treguesit e industrisë. Lannister sh.a ka fitim më të lartë operativ për shkak të kontrollit të shoenzimeve në mënyrë më efikase pasi që kapitali i angazhuar është shumë më i lartë se sa i Baratheon sh.a.

#### Koeficientët e likuiditetit

- (i) Lannister sh.a është duke i paguar llogaritë e pagueshme më shpejtë se sa Baratheon sh.a dhe më shpejt se sa praktikat normale. Ndoshta ata janë gjithashtu duke marr zbritje për pagesa të mëhershme.
- (ii) Stoqet e Lannister sh.a janë duke lëvizur më shpejt se sa të Baratheon sh.a dhe më shpejt se sa praktikat normale. Lannister sh.a ndoshta është duke iu dhënë klientëve zbritje tregtare për të shitur stoqet më shpejt dhe zvogëloj shpenzimet siç janë ato të shpërndarjes.
- (iii) Të dy kompanitë kanë raportuar koeficientë të shpejtë më të mirë në shikim të parë por një analizë e kujdesshme tregon se Baratheon sh.a nuk ka para të gatshme të mjaftueshme për të paguar të pagueshmet tregtare dhe i duhen 3 muaj për të paguar furnitorët e tij dhe kjo mund të ndikoj në vlerësimin kreditor.

#### Koeficientët e leverazhit

- (i) Lannister sh.a nuk ka huamarrje afatgjatë, kjo për shkak të pozitës së shëndoshë të parasë së gatshme përderisa Baratheon sh.a ka nota krediti 10% të cilat do të bejnë më shumë presion në rrjedhat e parasë e cila veç se është më e dobët. Edhe pse borxh/ekuitet është më i ulët se sektori i njejtë, kompania duhet të paguaj kostot e financimit si shtëse ndaj të pagueshmeve tregtare.

### Koeficientët e investitorëve

- (i) Lannister sh.a është në gjendje që të paguaj më shumë dividendë aksionarëve të saj të ekuitetit se sa Baratheon sh.a dhe më shumë se sa është e pritshme në industri. Kjo rrit konfidencën e investitorëve në kompani.

### **Rekomandim**

Stark sh.a duhet ta blejë Lannister sh.a dhe jo Baratheon sh.a për këto arsye:

- (i) Në përgjithësi Lannister sh.a është më profitabil se sa Baratheon sh.a dhe më shumë se sa që pritet në këtë industri.
- (ii) Lannister sh.a është më shumë efikas se sa Baratheon sh.a dhe më shumë se sa që pritet në këtë industri.
- (iii) Lannister sh.a ka pozitë më të mirë të likuiditetit se sa Baratheon sh.a dhe më të mirë se sa pritet në këtë industri.
- (iv) Lannister sh.a nuk ka huamarrje krahasuar me Baratheon sh.a.
- (v) Lannister sh.a është më shumë në gjendje të paguaj dividendë të ekuitetit se sa Baratheon sh.a dhe më shumë se sa pritet në këtë industri.